



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE
OF THE PRIME MINISTER/ URED
PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE /
AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST
POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Klinë, 25 maj 2021

OJQ Zana është përfituese e projektit “**Fuqizimi ekonomik dhe shoqëror i grave nga zonat rurale në fushën e bujqësisë**” financuar nga Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit - Republika e Kosovës. Masa 4 Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi, duke targetuar gratë nga zonat rurale të vetë punësuar në sektorin e bujqësisë. Projekti ka për synim të bëjë shpërndarjen e 6 (gjashtë) serave nga 50 metra katrorë.

Paramasat për sera 50 metra katror

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Çmimi
	Sera 50 metra kaltëror		
	Furnizimi dhe vendosja e gypit Ø42 për montimin e shtyllave të seres. Gypi të vendoset në tokë në thellësi prej 40 cm, ndërsa mbi tokë të mbetet 15 cm. Përforcimi të bëhet me profil metalik në formë kryqi		
	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave në mes të seres Ø 42 në distancë 2.00 metra dhe me lartësi 3.00 metra		
	Furnizimi dhe vendosja e harqeve Ø 42 dhe më gjatësi 6.00 m		
	Furnizimi dhe vendosja e trajtave gjatësore Ø 25 më gjatësi 10 m		
	Furnizimi dhe vendosja e trajtave Ø 25 më gjatësi 5 m		
	Furnizimi dhe vendosja e dyerve 140x220, 40x20x2 mm, rami 30x20x2 mm		
	Furnizimi dhe vendosja e vintave lëvizës për ajrosjen e seres		
	Furnizimi dhe vendosja e shtangimeve X të bëhet në fillim të seres, në		

	fund me qypa Ø 20		
	Furnizimi dhe vendosja e telit për shtangim e folisë së seres 0.4 mm		
	Furnizimi dhe vendosja e foljes plastike me UV 150 mik më garancinë tre (3) vjeçar.		
	Pompë uji (te përshtatshme për serat)		
	Ventilator (për pastrim ajri)		
	Tub uji		
	Sistemi i ujitjes pikë-pikë		

Ofertuesit për ndërtimin e serave duhet të ofrojnë dëshmi se serat do të i përmbushin standardet e mëposhtme:

- Të jenë rezistuese; të ketë jetëgjatësi sa më të madhe; të garantojnë qëndrueshmëri dhe ruajte sa më të mirë të temperaturave; nuk ndryshket dhe mban cilësi me te larte te produktit.

Serat po ashtu duhet të posedojnë :

- Pompë uji (te përshtatshme për serat)
- Ventilator (për pastrim ajri)
- Tub uji

Ofertuesit duhet të përfshijnë në propozimin e tyre edhe formën dhe parametrat e serës që më së miri garantojnë cilësi dhe jetëgjatësi si dhe të bëjnë planin dinamik për ndërtimin e serave përfshiu instalimin e të gjitha pajisjeve përcjellëse.

Kompanitë e interesuara ofertës së tyre duhet të ja bashkëngjitin edhe dokumentet si në vijim:

- Kopjen e Certifikatës së regjistrimit të biznesit apo OJQ-së të lëshuar nga Institucionet e Republikës së Kosovës
- Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik të aplikuesit që vërteton se organizata nuk ka borxhe, dhe në rast se ka borxh publik, duhet të paguhet para nënshkrimit të kontratës. Certifikata duhet të jetë jo më e vjetër se 6 muaj.
- Rekomandime apo dëshmi nga kontraktues të mëhershëm për të njëjtin aktivitet
- Plan dinamik – i detajuar për ndërtim të një sere.

Kompania fituese do të shpallet ajo që ofron **Çmimin më të favorshëm ekonomik**
Thirrja hapet me datë: 25.05.2021- deri me 5 Qershor 2021.

Ofertat duhet të dorëzohet te mbyllura ne zarf më së voni **deri më 07 Qershor 2021 ora 12:00 në zyrat e OJQ Zana Rruga Abedin Rexha p.n. Klinë**